



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.18.1-2014-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014**

**Prishtinë, Qershor 2015**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa mund të ndërmerr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Prizrenit në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Sejdiu, i mbështetur nga Florim Maliqi (Udhëheqës Ekipi), Bekim Mikullovcit dhe Radojica Milovanoviq.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet tjera për raportimin e jashtëm .....	9
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	12
4 Qeverisja.....	13
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	33
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak .....	36


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Prizrenit për vitin 2014 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 13/10/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:


Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Si *Theksim të Çështjes* ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Regjistri i Pasurive Fikse dhe shpalosja e tyre në PVF nuk është i plotë dhe si pasojë e keqklasifikimeve, investimet kapitale ishin mbideklaruar për 487,000€ dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin nën-deklaruar për të njejtën shumë;

**(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes)**

## Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e komunës janë:





### **Përgjigjja e Menaxhmentit**

Menaxhmenti i komunës është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet tona.

Ne e marrim si punë të kryer që Kryetari:

- Të diskutoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit Janar/shkurt 2016 të inicioj diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e financave.

## 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e menaxhmentit të komunës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shpreh opinionin:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operacionale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.



## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet tjera për raportimin e jashtëm

### Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### Konkluzion i përgjithshëm

Komuna e Prizrenit nuk ka arritur ta adresojë çështjen e gabimit material në pasuritë e prezentuara në PVF. Përveç kësaj, shuma 487,000€ e shpenzuar për mallra dhe shërbime është keqklasifikuar si investime kapitale, dhe shuma 11,000€ është paguar në mënyrë të parregullt. Andaj, 'Deklarata' e bërë nga Kryetari i komunës dhe ZKF, të cilës i jemi referuar më lartë, nuk ishte e saktë në të gjitha aspektet. Kjo ka rezultuar me Theksim të Çështjes. Të gjitha obligimet tjera të raportimit të jashtëm që nuk kanë lidhje me PVF ishin përmbushur plotësisht.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim të Çështjes* ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Regjistri i Pasurive Fikse dhe shpalojsja e tyre në PVF nuk është i plotë dhe si pasojë e keqklasifikimeve, investimet kapitale ishin mbideklaruar për 487,000€ dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin nën-deklaruar për të njejtën shumë;

**(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes)**

### 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

#### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, e datës 13.10.2014, është identifikuar një rrezik domethënës në PVF lidhur me plotësinë e pasurive.

Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me plotësinë e pasurive ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rreziqet e paraqitura. Mungesa e veprimit mund të rezultojë në Theksim të Çështjes.

### **Rreziku i identifikuar**

#### **Çështja 1 - Mos regjistrimi i të gjitha pasurive mund të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive të prezentuara në PVF**

Pasuritë në pronësi të komunës me vlerë mbi 1,000€ nuk ishin regjistruar plotësisht në regjistrin kontabël të pasurive, duke rezultuar kështu në anomali materiale në shënimet e PVF. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimet që nevojiten të ndërmerren për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të jetë e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar ngase menaxhmenti nuk ka zbatuar përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi konfirmuar se vlera e pasurive në PVF nuk është e plotë.

**Rekomandimi 1**      **Prioritet i Lartë** – Kryetari i komunës duhet të inicijojë një analizë për arsyet për përsëritjen e gabimeve në paraqitjen e vlerave të pasurive në PVF dhe pamundësinë e komunës për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e gabimeve. Veprimet e duhura shpesh nga ana e menaxhmentit janë që të gjitha pasuritë me vlerën mbi 1,000€ të regjistrohen fillimisht në regjistrin kontabël, dhe më pastaj, e njëjta shumë të prezantohet në PVF të vitit 2015. Ky proces duhet të jetë nën monitorim direkt nga ana e Kryetarit.

## **2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim**

Komuna e Prizrenit duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Raportet operative (të performancës);
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë;

Kërkesat tjera për raportim ato ishin përmbushur plotësisht, me përjashtim të Raportit të Performancës për vitin 2013, i cili nuk ishte përgatitur dhe publikuar

Në draft Pasqyrat Financiare janë vërejtur disa mangësi. Ne kemi dhënë disa sugjerime për të përmirësuar prezentimet në PVF dhe për të siguruar plotësinë e disa shpalosjeve. Këto janë paraqitur në vijim.

## Çështja 2 - Përgatitja e PVF - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Menaxhmenti nuk ka zbatuar një rishikim efektiv të procesit të përgatitjes së PVF-ve i cili ka rezultuar me gabime si në vijim:

- Në raportin e ekzekutimit të buxhetit të kolona B (buxheti final) ishte prezentuar shuma e alokimeve;
- Në shënimin 6 nuk ishin shpalosur pagesat nga palët e treta që në pasqyrën e pranimeve dhe pagesave është prezentuar shuma 100,000€;
- Pagesat nga Palët e Treta të prezentuara në pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në shumën 100,000€ nuk janë të regjistruara në SIMFK;
- Shpalosjet për investimet kapitale të shënimi 11 nuk ishin të plota. Ne kemi identifikuar që kjo shpalosje është mbivlerësuar me 487,000€ për shpenzime operative; dhe
- Shpalosjet mbi pasuritë e komunës nuk ishin të plota.

Pas këshillave tona për korrjimin e PVF-ve, ato ishin korrigjuar me përjashtim të tri pikave të fundit.

Marrë parasysh atë më lart, 'Deklarata' e bërë nga Kryetari dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet jo e plotë dhe e pasaktë. Kjo është bazë për Theksim të Çështjes apo Modifikim të Opinionit.

**Rreziku** Mungesa e një rishikimi efektiv të PVF-ve nga niveli i lartë i menaxhmentit ka rezultuar me gabime materiale të cilat mund të shpiejnë tek një opinion i modifikuar. Më tutje, PVF-të që përfshijnë gabime mund të konsiderohen si jo të besueshme, duke rezultuar kështu në dëmtim të kredibilitetit në raportimin financiar të komunës.

**Rekomandimi 2** Kryetari i komunës duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF-ve të vitit 2015 të adresojë të gjitha kërkesat e pajtueshmërisë. Duhet të ekzistojnë linjat raportuese dhe stafi menaxhues duhet të mbahet përgjegjës për cilësinë e regjistrimit dhe klasifikimit të saktë të shpenzimeve. Kjo kërkon monitorim të vazhdueshëm. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse në të gjitha draft PVF janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

### 3 Rekomandimet e vitit paraprak

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Pavarësisht përgatitjes së planit të veprimit për të adresuar rekomandimet e vitit 2013, një numër çështjesh të rëndësishme mbeten ende për t'u adresuar.

#### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 të Komunës së Prizrenit ka rezultuar me 18 rekomandime kryesore. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar plotësisht; gjashtë (6) janë zbatuar pjesërisht; dhe 6 (gjashtë) tjera nuk janë adresuar fare. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

---

#### Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i Lartë

<b>E gjetura</b>	Vetëm një pjesë e vogël e rekomandimeve të vitit të kaluar janë adresuar. Kjo ka ndodhur pasi që Komuna nuk ka zbatuar një proces formal për të menaxhuar, monitoruar dhe për të kërkuar llogari për progresin e zbatimit të rekomandimeve të AP-së.
<b>Rreziku</b>	Mos adresimi i rekomandimeve të auditimit për sistemet financiare kyçe, mund të rezultojë me përsëritje të: <ul style="list-style-type: none"><li>• Regjistrin të mangët të pasurive;</li><li>• Nivelit të ulët të ekzekutimit të buxhetit dhe mos përmbushjen e objektivave të përcaktuara;</li><li>• Dobësive të vazhdueshme në menaxhimin e të hyrave vetjake;</li><li>• Dobësive të vazhdueshme në shpenzimet përmes prokurimit dhe vlerë të dobët për paranë; dhe</li><li>• Përfitimimit të limituar nga puna e Auditimit të Brendshëm.</li></ul>
<b>Rekomandimi 3</b>	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të mbetura të vitit 2013 dhe ato të vitit 2014, i rishikuar, të përcaktojë një afat të qartë kohor të implementimit. Ky plan duhet të përcaktojë edhe stafin përgjegjës, duke u fokusuar fillimisht në fushat të rëndësishme më të madhe.

## 4 Qeverisja

### Konkluzioni i përgjithshëm

Qeverisja e fortë mbështetë planifikimin efektiv, implementimin dhe monitorimin e aktiviteteve të komunës.

Aspektet kyçe që duhet adresuar për të mundësuar një kornizë të mirëfilltë qeverisëse janë:

- Procedura të qarta dhe ndarje adekuate e detyrave për menaxhimin e proceseve;
- Menaxhimi i rrezikut;
- Monitorimi sistematik i aktiviteteve;
- Sistemi funksional të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Vetëvlerësimi.

Komuna nuk ka arritur të forcoj aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes, dhe si rezultat është pëcjellur me dobësi të ndryshme vit pas viti. Për më tepër, ZAP ka publikuar dokumentin për diskutim “Performanca financiare dhe shërbimi i ofruar në Komuna në vitin 2013”. Ky dokument do të duhej të ishte bazë për qasje më të fokusuar në përmirësimin e qeverisjes komunale. Është evidente që Komuna nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur këtij dokumenti për ta përmirësuar shërbimin e ofruar. Edhe ky vit fiskal karakterizohet me dobësi në menaxhimin e sistemeve kryesore:

- Komuna ka shpenzuar shuma të larta për dreka zyrtare si dhe shpenzime për vizita rekreative në buxhet, ndërkohë që komuna ka nevojë për investime në zhvillimin ekonomik dhe social të qytetarëve, dhe shumë projekte nuk janë realizuar për shkak të mungesës së buxhetit;
- Menaxhim i dobët i aktiviteteve për inkasimin e të hyrave vetjake. Kjo ka rezultuar me inkasim të ulët të të hyrave dhe menaxhim tejet të dobët të kontratave të dhënies së pronave të komunës me qira; dhe
- Dobësi në sistemin e prokurimit që kanë rezultuar me menaxhim të dobët të proceseve të prokurimit si në fazat planifikuese ashtu edhe gjatë realizimit të kontratave.

Të gjitha këto mund të shihen më hollësisht në vazhdim të këtij raporti.

### 4.1 Qeverisja e mirë

#### Përshkrimi

Procedurat e një qeverisje të mirë kanë për qëllim të konfirmojnë që menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është

e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur të menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve të identifikuara operative dhe financiare.

## Rekomandimet

---

### Çështja 4 - Dobësi në Kontrollin e Menaxhmentit të Lartë – Prioritet i Lartë

**E gjetura** Rishikimi i bërë kontrolleve të larta menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të Komunës së Prizrenit ka nxjerrë në pah një kontroll të dobët mbi shpenzimet dhe të hyrat. Kjo ka ndodhur për shkak se forma e raportimeve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth dallimeve ndërmjet buxhetit dhe realizimit.

**Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar tek menaxhmenti i lartë, redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës dhe dëmton kontrollin efektiv buxhetor. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. Kjo gjithashtu mund të bëjë që të hyrat të mos inkasohen në nivelin e pritur.

**Rekomandimi 4** Kryetari i komunës duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit cilësor financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, për të siguruar një menaxhim efektiv të veprimtarisë, dhe të paraqesë një zgjidhje të përshtatshme deri më 1 tetor 2015.

### Çështja 5 – Shmangie e procedurave të hapura të prokurimit – Prioritet i Mesëm

**E gjetura** Gjatë vitit 2014 Komuna ka zhvilluar 100 aktivitete të prokurimit me procedura të kuotimit të çmimeve për prokurime ku do të mund të përdorej procedurë e hapur e prokurimit. Në vazhdim janë paraqitur dy raste të tilla:

- Furnizimi me lëndë djegëse – dru për shkolla, ishte subjekt i dy prokurimeve me kuotim në vlerë totale prej 21,660€. Komuna kishte një kontratë prej 179,580€ të realizuar me procedurë të hapur për furnizim të tillë; dhe
- Komuna kishte bërë tri kontrata në vlerë totale 28,540€ me kuotim të çmimeve për organizimin e tri festivaleve tradicionale.

Vlera totale e kontratave me kuotim të çmimeve arrin shumën 805,078€.

**Rreziku** Komuna nuk aplikon procedura të duhura të prokurimit. Përdorimi i procedurës së kuotimit për shpenzime që mund të realizohen me procedurë të hapur, shton rrezikun e përfitimit të ulët të vlerës për para, eliminon konkurrencën dhe mund të jetë subjekt i mashtrimit.

**Rekomandimi 5** Kryetari i komunës duhet të iniciojë një analizë për arsyeshmërinë e një numri kaq të lartë të kuotimeve, me theks të veçantë në rastet kur për shpenzime të njejta ekziston kontratë me procedurë të hapur. Kryetari duhet të forcojë kontrollet në planifikimin dhe realizimin e prokurimit duke siguruar që për shpenzimet e natyrës së njëjtë do të përdoren procedurat e hapura për të arritur vlerën më të lartë për parane e paguar.

## 4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

### Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>35,877,659</b>	<b>39,476,719</b>	<b>33,265,428</b>	<b>31,780,415</b>	<b>30,274,489</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	29,452,625	31,976,693	28,783,661	27,324,442	25,683,770
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup> –	0	883,066	753,697	887,220	976,455
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	6,425,034	6,425,034	3,634,429	3,364,987	3,317,382
Donacionet e brendshme	0	93,120	37,796	153,878	125,610
Donacionet e jashtme	0	98,806	55,845	49,888	171,272

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 3,599,060€. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i:

- Rritjes së grantit qeveritar në shumë 2,524,068€ në bazë të vendimit të qeverisë;
- Rritjes së donacioneve të brendshme dhe të jashtme në shumë prej 191,926€; dhe
- Bartjes së të hyrave vetjake të vitit 2013 në shumë prej 883,066€.

Në vitin 2014, Komuna ka shpenzuar 84% të buxhetit final, me një shkallë më të ulët prej 6% krahasuar me vitin 2013. Përgjithësisht, realizimi i buxhetit është në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>35,877,659</b>	<b>39,476,719</b>	<b>33,265,428</b>	<b>31,780,415</b>	<b>30,274,489</b>
Pagat dhe Mëditjet	15,229,800	17,917,124	17,766,430	15,139,595	14,856,794
Mallrat dhe Shërbimet	3,172,120	3,388,150	2,477,087	2,585,716	2,082,843
Shërbimet komunale	1,097,777	1,097,777	864,970	804,029	802,795
Subvencionet dhe Transferet	535,979	535,979	521,614	504,157	350,288
Investimet Kapitale	15,841,983	16,537,689	11,635,326	12,746,918	12,181,769

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me atë fillestar ishte rritur për 695,705€, ndërsa shkalla e shpenzimeve për këtë kategori ishte vetëm 70% e buxhetit apo 12% më pak se vitin paraprak, e që prezenton një performancë të dobët buxhetore. Ky buxhet është planifikuar të shpenzohej për projektet në vazhdim dhe për projekte të reja. Shkalla e ulët e shpenzimeve ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve për të bërë një planifikim të mirëfilltë dhe menaxhim adekuat të kontratave. Si pasojë, disa projekte nuk kanë filluar fare, e te disa të tjera kanë ndodhur vonesa në realizimin e punëve;
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje me 2,687,324€ ka ndodhur për shkak të vendimit të Qeverisë për ngritjen e pagave për 25%. Në fund të vitit 2014, Komuna kishte përfunduar me 174,155€ obligime ndaj personelit arsimor për shkak të mungesës së fondeve për këtë kategori. Kjo ka ndodhur pasi që Komuna nuk ka arritur të bëjë një planifikim të duhur rreth nevojave për paga në arsim. Duke pasur parasysh edhe tejkalimin e 1/12 së buxhetit për paga në janar 2015 në shumë 16,729€, kjo praktikë mund ta shpie komunën në vështirësi financiare që mund të pasojë me dështim të komunës në ofrimin e shërbimeve dhe realizimin e investimeve;
- Buxheti për mallra dhe shërbime është rritur për 216,030€ ndonëse shkalla e përgjithshme e shpenzimit në këtë kategori është vetëm 73% e ndarjes buxhetore. Ky nivel i ekzekutimit të buxhetit është si pasojë e mungesës së një planifikimi buxhetor që është reflektim i nevojave reale të komunës. Përderisa ekzekutimi i buxhetit është i ulët, obligimet e komunës në këtë kategori kanë shënuar rritje nga 70,000€ sa ishin në fund të vitit 2013 në rreth 124,000€ në fund të vitit 2014. Në anën tjetër Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë proces formal për ta menaxhuar vendimin e Qeverisë për zvogëlim të buxhetit për mallra dhe shërbime me 15%. Kjo nuk ka pasur ndonjë ndikim në aktivitetet e komunës duke pasur parasysh nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit. Sidoqoftë, Komuna duhet të tregohet e matur duke ndërmarrë aranzhime adekuate për menaxhimin e shkurtimeve buxhetore që mund të paraqiten në të ardhmen;



- Buxheti për shërbimet komunale ishte shpenzuar në nivel 79%. Shuma prej 232,807€ kishte mbetur e pashpenzuar ndërsa në anën tjetër obligimet e papaguara për këtë kategori në fund të vitit ishin 45,598€. Kjo ka ndodhur për shkak të pamundësisë së komunës për të planifikuar dhe menaxhuar me buxhetin në dispozicion;
- Komuna ka pranuar donacione të brendshme dhe të jashtme në shumë 191,925€, ndërsa kishte ekzekutuar vetëm 93,641€ apo më pak se gjysmën e tyre. Kjo ka ndodhur për shkak të performancës së dobët të komunës për shfrytëzimin e donacioneve që ka pasur ndikim negativ në përmbushjen e planeve të komunës; dhe
- Komunën e Prizrenit vit pas viti e përcjellë një trend në rritje i shfrytëzimit të ulët të hyrave vetjake. Për shkak të performancës së dobët buxhetore në fund të vitit 2013 ishin bartur 883,000€ ndërsa në fund të vitit 2014 kjo shumë arrin në 1,848,000€. Në një kohë kur nevoja për investime është e lartë, dështimi në shfrytëzimin e të hyrave vetjake për investime mund të jetë destimulues për qytetarët që t'i paguajnë obligimet e tyre ndaj komunës, me theks të veçantë ato për tatimin në pronë.

## Rekomandimet

---

### Çështja 6- Mbivlerësimi i investimeve kapitale - Prioritet i Lartë

- E gjetura** Komuna ka paguar 487,000€ për shpenzime të natyrës operative nga buxheti për investime kapitale. Kjo ka ndodhur për shkak të dobësisë së komunës për të planifikuar dhe për shkak të kufizimeve nga MF për të buxhetuar të gjitha shumatat e nevojshme në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.
- Rreziku** Mbivlerësimi i shpenzimeve për investime kapitale mund të shpie në keqkuptim të pozitës financiare të komunës dhe mund të ketë ndikim në opinionin e auditimit.
- Rekomandimi 6** Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që të gjitha shpenzimet planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe se ato nuk do të jenë subjekt i keq klasifikimit në PVF-të e vitit 2015.

### Çështja 7 - Ekzekutim i ulët i buxhetit - Prioritet i Lartë

- E gjetura** Komuna ka treguar një nivel të ulët të realizimit të buxhetit në të gjitha kategoritë e shpenzimeve, përveç për paga dhe mëditje. Ekzekutimi i ulët i buxhetit vërehet për investime kapitale (70%) dhe për mallra dhe shërbime (75%). Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së planifikimit dhe kontrollit sistematik buxhetor të komunës dhe pjesërisht për shkak të disa faktorëve të jashtëm.

**Rreziku** Ekzekutimi i ulët i buxhetit përveç që tregon një performancë të dobët, redukton efektivitetin e planeve të shpenzimeve të komunës. Për më tepër, mos-përmbushja e programit buxhetor mund të rezultojë në reduktim të grantit qeveritar dhe humbje të donacioneve me pasoja në ngecje të zhvillimit të gjithmbarshëm të komunës.

**Rekomandimi 7** Kryetari i komunës duhet ta bëjë një vlerësim sistematik të shkaqeve që kanë çuar në një nivel të ulët të ekzekutimit të buxhetit dhe përsëritjes së situatës vit pas viti. Kryetari duhet të përcaktojë mënyra praktike për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në periudhat e ardhshme, dhe të vendosë një monitorim sistematik mbi ekzekutimin e buxhetit të planifikuar.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2014 (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetjake	6,425,034	6,425,034	5,353,482	4,020,374	4,339,726

Gjatë vitit 2014 Komuna kishte arritur të inkasojë 83% të të hyrave vetjake të planifikuara. Niveli i inakasimit të të hyrave vetjake ka shënuar një rritje prej 25% krahasuar me vitin 2013, si dhe 23% më shumë se viti 2012. Një rritje e të hyrave në vitin 2014 ka ndodhur si rezultat i të hyrave tjera indirekte të mbledhura nga gjrobat, vendimet gjyqësore si dhe ato të agjensionit pyjore.

### 4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

#### Përshkrimi

Të hyrat e gjithmbarshme në komunën e Prizrenit për vitin 2014 ishin 5,353,482€. Prej tyre 4,227,247€ janë mbledhur nga Komuna ndërsa 1,126,235€ janë të hyra nga gjrobat e trafikut, gjykatat dhe agjensioni pyjor.

Komuna ka vendosur një gamë të kontrolleve për inkasimin e të hyrave vetjake por këto kontrolle duhet të forcohen dhe monitorohen në mënyrë sistematike për të dhënë rezultatin e pritur.

#### Rekomandimet

#### Çështja 8 – Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetjake – Prioritet i Lartë

**E gjetura** Komuna nuk ka arritur të vendos kontrolle efektive për inkasim që do të siguronin një planifikim real të pasuar me mekanizma adekuat për inkasimin e të hyrave të planifikuara. Në vazhdim janë paraqitur dy raste që janë pasojë e këtyre dobësive:

- Komuna kishte planifikuar taksën për menaxhimin e mbeturinave në shumë prej 1,200,000€ ndërsa inkasimi i kësaj takse për vitin 2014 ishte zero (0); dhe

- Faturimi për tatim në pronë për vitin 2014 arrinte shumën 2,117,263€, ndërsa inkasimi ishte 1,824,232€ apo 86% nga shuma totale e faturuar. Krahasuar me vitin 2013, shkalla e realizimit të planifikimit për tatimin në pronë ka shënuar rënie prej 20%. Komuna nuk ka aplikuar ndonjë qasje pro aktive për mbledhjen e tatimit në pronë. Nga testimi i 16 mostrave, kemi gjetur se 7 prej tyre vite me rradhë nuk kishin paguar asnjë cent. Kjo mund të jetë edhe për shkak që Komuna nuk ka arritur nivel të kënaqshëm që mjetet e mbledhura t'ua rikthejë qytetarëve në investime publike. Një pjesë e të hyrave të painkasuara nga tatimi në pronë janë për pronat nën menaxhimin e AKP-së.

**Rreziku** Mungesa e kontrolleve efektive në menaxhimin e të hyrave vetjake do të vazhdojë të rezultojë me shkallë të ulët të inkasimit të tyre. Si pasojë, Komuna do të ballafaqohet me mundësi të reduktuara për realizimin e objektivave në ofrimin e shërbimeve dhe në investimet kapitale të financuara nga të hyrat vetjake.

**Rekomandimi 8** Kryetari i komunës duhet të iniciojë një analizë gjithëpërfshirëse për ngecjen në zbatimin e rekomandimit për eliminimin e dobësive në menaxhimin e të hyrave vetjake. Një zgjidhje duhet të ofrohet dhe të vendosen kontrolle të qëndrueshme që sigurojnë një planifikim të mirëfilltë dhe inkasim efektiv.

#### **Çështja 9 – Lejet e ndërtimit – Prioritet i Mesëm**

**E gjetura** Një prej burimeve kryesore i të hyrave vetjake është ai nga lejet e ndërtimit. Të hyrat e komunës për leje ndërtimi në vitin 2014 ishin 593,643€. Rishikimi ynë ka identifikuar që nga 784 kërkesa të bëra gjatë vitit, vetëm 502 prej tyre ishin aprovuar dokumentacioni i kërkuar nuk është plotësuar. Ne kemi vërejtur që edhe ata të cilët janë pajisur me leje ndërtimi, nuk i përmbahen kriterëve të përcaktuara nga urbanizmi. Për më tepër, Komuna nuk ka ndërmarrë masa adekuate për ndalimin e kësaj praktike.

**E gjetura** Komuna nuk arritur të vendos kontrolle efektive dhe monitorim të duhur gjatë trajtimit të rasteve të ndërtimit. Numri i ulët i trajtimit të aplikacioneve për leje ndërtimi ka ndikim direkt në uljen e të hyrave potenciale nga ky burim dhe në shtimin e rrezikut për ngritje të numrit të ndërtimeve ilegale. Në anën tjetër, mungesa e kontrolleve dhe monitorimit të procesit të lëshimit të lejeve ndërtimore, mund të rezultojë me shkelje të kërkesave ligjore dhe standardeve të ndërtimit.

**Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë që numër i mjaftueshëm i stafit të shkathët është i angazhuar në drejtorinë e urbanizmit dhe me kohë trajton të gjitha aplikacionet për leje ndërtimi. Kontrollat dhe monitorimi në këtë proces duhet të forcohen për të parandaluar ndërtimet pa leje dhe mbindërtimet. Nëse është e nevojshme, të aplikojë edhe ndëshkimet e parapara me ligj.

## Çështja 10 - Dobësi në kontratat e koncesioneve dhe qiradhënies - Prioritet i Lartë

### E gjetura

Ne kemi identifikuar dobësi në menaxhimin e kontratave të dhënies së pronave të komunës me koncesion dhe me qira. Si pasojë e këtyre dobësive, nga totali i ngarkesave vjetore prej 249,284€ për shfrytëzimin e pronave komunale gjatë vitit 2014, vetëm 44,844€ (17%) ishin inkasuar. Në vazhdim janë paraqitur disa raste më të theksuara:

- Komuna ka bërë tri (3) kontrata me “Is - Company” për shfrytëzimin e pronës komunale. Ngarkesa e qirasë për vitin 2014 ishte 84,000€ ndërsa qiramarrësi kishte paguar vetëm 14,000€. Komuna kishte kërkuar që qiramarrësi të paguajë borxhin paraprak për të vazhduar shfrytëzimin e pronës komunale. Një gjë e tillë nuk kishte ndodhur ndërsa kompania vazhdon shfrytëzimin e pronës. Për më tepër, ky qiramarrës është shpërblyer nga Komuna me një kontratë prej 161,929€ për kryerjen e disa punimeve;
- Kompania “Alcom Construction” ka kontratë me komunën. Obligimi i kompanisë ndaj komunës për vitin 2014 ishte 12,420€ ndërsa inkasimi ishte zero (0);
- Kompania “Auto-Teuta” për shfrytëzimin e pronës komunale ka obligim 71,754€, ndërsa inkasimi nga ky qiramarrës ishte zero (0);
- Komuna ka kontratë me “Shoqatën e Invalidëve të UÇK-së” për shfrytëzimin e pronës komunale. Obligimi i Shoqatës ishte 26,798€ ndërsa inkasimi ishte zero (0);
- Komuna kishte lidhur kontrata me pesë (5) kompani për shfrytëzimin e pronës komunale për parkingje. Obligimi që këto kompani kishin ndaj komunës arrinte shumën 52,688€ ndërsa inkasimi prej tyre ishte vetëm 6,760€; dhe
- Gjatë vitit 2014 Komuna kishte lëshuar disa prona/lokale me qira pa lidhur kontratë me shfrytëzuesit e pronave. Qiramarrësit nuk kishin paguar të gjitha obligimet e tyre dhe borxhi ndaj komunës për këtë periudhë ishte 177,251€. Komuna nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për inkasimin e këtij borxhi.

**Rreziku** Vetëm nga rastet e përmendura më lartë del se ekziston një shumë e borxheve të pa mbledhura nga qiramarrësit prej mbi 400,000€. Ky fakt shpalos dobësi serioze në zbatimin e kontrolleve të komunës për pronat e dhëna me qira. Dobësitë e identifikuara në menaxhimin e kontratave të koncesioneve dhe qiradhënieve rezultojnë me humbje të konsiderueshme financiare për komunën dhe reduktojnë aftësinë e komunës për financimin e projekteve nga burimet vetjake.

**Rekomandimi 10** Kryetari i komunës duhet të inicojë veprime të menjëhershme duke bërë një vlerësim detal për arsyet prapa nivelit të ulët të inkasimit në fushën e pronave të dhëna në shfrytëzim. duhet të vendosen masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme të inkasoj të gjitha borxhet e prapambetura, ose në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike.

## 4.4 Shpenzimet

### 4.4.1 Prokurimi

#### Përshkrimi

Shpenzimet për investime kapitale gjatë vitit 2014 ishin 11,635,326€, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin 2,477,088€, ku pjesa dërmuese i nënshtrohet procedurave të prokurimit.

Komuna e Prizrenit në vitin 2014 ka zhvilluar 206 aktivitete të prokurimit, prej të cilave 29 janë anuluar. Vlera e 157 kontratave të lidhura arrin 5,134,347€.

#### Rekomandimet

---

### Çështja 11 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Rishikimi ynë ka identifikuar raste të pranimit të shërbimeve disa muaj pas përfundimit të tyre. Për më tepër, këto shpenzime janë planifikuar dhe ekzekutuar nga buxheti për investime kapitale ndërsa i takojnë kategorisë së shërbimeve. Dy raste të tilla janë paraqitur në vazhdim:

- Komuna me 07.02.2014 i kishte paguar operatorit “Ekoregjioni” shumën 67,215€ për mirëmbajte verore të rrugëve. Paguesa ishte për shërbime të kryera gjatë periudhës shtator-dhjetor 2013, ndërsa pranimi i punëve kishte ndodhur me 04.02.2014. Procesverbali i pranimit të punës nuk përmban informata se cilat punë/shërbime janë kryer. Vonesat në pagesa kanë ndodhur për shkak të mungesës së fondeve.

- Rast i ngjashëm kishte ndodhë edhe me pagesën e datës 06.02.2014, ku komuna i kishte paguar operatorit “Shërbimi” shumën 82,047€ për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve. Pagesa ishte për shërbime të kryera gjatë periudhës shtator-dhjetor 2013, ndërsa pranimi i punëve kishte ndodhur me 04.02.2014.

Baza mbi të cilën janë kryer këto pagesa, nuk është e mjaftueshme dhe nuk konfirmon sasinë e punëve/shërbimeve të kryera nga operatorët më sipër. Komuna nuk ka një dokument që specifikon në mënyrë të qartë çfarë veprimesh do të përmbante mirëmbajtja e rrugëve në përputhje me kushtet e motit.

**Rreziku** Pranimi i punëve disa muaj pas përfundimit të tyre, shton rrezikun që Komuna të paguajë për punë/shërbime që nuk kanë ndodhur. Një praktikë e tillë mund të jetë edhe subjekt i mashtrimit, ndërsa keqklasifikimi i shpenzimeve mund të jetë subjekt i Modifikimit të Opinionit.

**Rekomandimi 11** Kryetari i komunës duhet t’i forcojë kontrollet me rastin e pranimit të shërbimeve apo punëve. Kryetari duhet të sigurojë që organet mbikëqyrëse bëjnë pranimin e punëve apo shërbimeve menjëherë pas përfundimit. Hartimi i një specifikacioni të qartë për këto shërbime në përputhje me kushtet e motit, duhet të konsiderohet nga ana e Kryetarit.

## Çështja 12 - Përshtatje e tenderit - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Komuna kishte blerë një veturë të përdorur duke paguar shumën 9,800€. Kriteret e përdorura në procedurën e prokurimit për “Furnizim me një veturë të përdorur” ishin në kundërshtim me LPP-në. Kriteret e tenderit ishin favorizuese duke përcaktuar që vetura duhet të jetë e përdorur, viti i prodhimit të jetë 2009 dhe të ketë 129,000 km të kaluara.

**Rreziku** Caktimi i kriterëve favorizuese përveç që paraqet shkelje të LPP-së shton rrezikun e mos arritjes së vlerës për para dhe për mundësinë e mashtrimit. Praktika të tilla e dëmtojnë reputacionin e komunës dhe humbin besimin e ofertuesve potencial në një proces të prokurimit të drejtë dhe transparent.

**Rekomandimi 12** Kryetari duhet të analizojë shkaqet që kanë çuar në një proces të tillë të prokurimit dhe të siguroj se çdo blerje përmes prokurimit, do të bëhet në përputhje të plotë me procedurat dhe parimet e LPP-së, duke siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit.

### Çështja 13 – Dobësi në tenderin për trajtimin e qenve endacak – Prioritet i Lartë

**E gjetura** Komuna kishte lidhur kontratë për eliminimin e qenve endacak. Procesi i parë i tenderimit ishte anuluar për shkak të mungesës së dy operatorëve të përgjegjshëm. Gjatë procesit të dytë të tenderimit ishte paraqitur vetëm një ofertues i cili kishte fituar kontratën në vlerë 56,700€. Kjo kontratë parashihte eliminimin e 700 qenve dhe përmbante dy pozicione:

1. Për zënie, transportin, grumbullimin, përkujdesjen dhe qëndrimin e qenve në strehimore, me çmim prej 61€ për qen; dhe
2. Për aplikimin e eutanazisë, groposjen dhe dezinfektimin e sipërfaqes, me çmim prej 20€ për qen.

Ne kemi vërejtur që operatori ka faturuar çmimin total prej 81€ për çdo qen të zënë. Kjo kosto për qen paraqitet mjaft e lartë krahasuar me koston prej 31€ për qen që shpenzon Komuna e Prishtinës. Komuna nuk kishte kryer ndonjë proces formal për vlerësimin e situatës dhe nevojave për këtë shërbim dhe nuk posedon dëshmi të mjaftueshme për formën e trajtimit të qenve të kapur. Për më tepër, është i pakuptimtë fakti që Komuna ka planifikuar shumën e njëjte për këtë shërbim për katër vite me radhë, duke konsideruar që numri i qenve do të mbetet i njëjte gjatë viteve.

**Rreziku** Faturimi me çmimin total të dy pozicioneve, shton rrezikun që Komuna të paguajë kosto joreale për çdo qen të trajtuar. Edhe mungesa e dy ofertuesve mund të paraqes rrezik për përshtatje të kriterëve të tenderit, duke pasur parasysh që shërbime të tilla ofrohen edhe në qytetet tjera të Kosovës.

**Rekomandimi 13** Kryetari i komunës duhet të iniciojë një proces të detajuar shqyrtimi për të qartësuar se çfarë realisht ka ndodhë me këtë kontratë dhe cilat ishin efektet e arritura. Duhet të merren masa administrative aty ku është e mundur. Në rastet vijuese, duhet të konfirmohet se vlerësimi i nevojave paraqet gjendjen reale, se LPP është respektuar gjatë procesit të tenderit, dhe se janë paguar kostot reale për trajtimin e qenve. Kontrolllet e prokurimit publik duhet të forcohen për të siguruar që aplikohet proces transparent i tenderimit dhe se arrihet vlera e duhur për paranë e shpenzuar.

### Çështja 14 – Tejkallim i buxhetit për riparim të rrugëve – Prioritet i Mesëm

**E gjetura** Për vitin 2014 Komuna kishte planifikuar të shpenzojë 350,000€ për riparimin e rrugëve ndërsa shpenzimet e ndodhura ishin 449,858€ për shkak të pagesës së disa situacioneve nga viti 2013. Shuma e mbi shpenzuar ishte marrur nga projektet tjera. Për më tepër, për një pagesë të vitit 2013 në shumë 60,029€, e që ishte paguar me 03.04.2014, raporti i pranimit të punëve nuk ishte i nënshkruar nga organi mbikëqyrës.

**Rreziku** Pagesat e tilla janë në kundërshtim me rregullat financiare. Tejkalimi i buxhetit për një projekt shkakton mosrealizim të projekteve tjera. Mungesa e nënshkrimit të organit mbikëqyrës në raportin e pranimit, shton rrezikun që Komuna të paguajë për punë apo shërbime të pa kryera.

**Rekomandimi 14** Kryetari i komunës duhet të forcojë kontrollet mbi planifikimin e mirëfilltë dhe shpenzime brenda ndarjeve të caktuara buxhetore. Kontrollet gjatë pranimit të punëve duhet të forcohen dhe raportet e pranimit të panëshkruara nga organi mbikëqyrës, duhet të mos merren parasysh. Kryetari duhet të konsideroj forcimin e kontroleve për të siguruar kualitet më të lartë gjatë ndërtimit të rrugëve në mënyrë që të zvogëlojë shpenzimet për riparimin e shpeshtë.

### **Çështja 15 – Dobësi në tenderin për instalim të ndriçimit publik – Prioritet i Mesëm**

**E gjetura** Me datën 14.12.2012 Komuna kishte lidhur kontratë me Operatorin Ekonomik (OE) "Multi Business Group" për instalimin e ndriçimit publik. Vlera e kontratës ishte bazuar në çmimin për njësi dhe ishte në shumë 2,999€. Një pjesë e konsiderueshme e artikujve ishin ofruar me çmim jo normalisht të ulët 0.10€. Ne kemi rishikuar pagesën në shumë prej 134,520€ e bërë në datën 10.02.2014 që kryesisht ishte për furnizime me poqa elektrik dhe furnizime tjera teknike. Nga 105 artikujt e ofertuar kryesisht ishin furnizuar dhe paguar 52 sish. Për më tepër, procesverbali i pranimit të punëve nuk përmbante detale se në cilën lagje janë kryer këto instalime.

**Rreziku** Oferta me artikuj me çmim jo normalisht të ulët dhe kërkesa për furnizim kryesisht me artikuj me çmime më të larta, shton rrezikun për përshtatje dhe favorizim të një operatori ekonomik të caktuar. Në anën tjetër, mungesa e informatave se në cilat lagje janë kryer punët, shton rrezikun që Komuna të paguaj për punë që nuk kanë ndodhur, apo të paguaj dy herë për artikuj të njëjtë.

**Rekomandimi 15** Kryetari i komunës duhet të sigurojë se përgatitja e paramasave bëhet në mënyrë profesionale dhe reflekton nevojat reale për artikujt/projektin e caktuar. Kualiteti i dokumentimit të punëve të kryera duhet të përmirësohet për t'u siguruar që pagesa bëhet vetëm për punët që janë kryer dhe që është arritur vlera për paranë e paguar.



### Çështja 16 - Mungesa e situacionit/dëshmime për punë/mallra - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Për shkak të dështimit të komunës për t'iu përmbajtur kërkesave ligjore për pranimin e punëve, gjegjësisht mallrave, janë paraqitur dobësitë në vijim:

- Me 17.07.2014 është paguar shuma 50,000€ për një situacion të projektit "Ndërtimi i kompleksit memorial të dëshmorëve të kombit" në varrezat e Landovicës. Me rastin e testimin të kësaj pagese, ne nuk kemi gjetur se ky situacion është pranuar nga ndonjë komision apo organ mbikëqyrës i projektit; dhe
- Komuna kishte paguar 57,132€ për furnizim me thëngjill për shkollat e komunës së Prizrenit. Procesverbali nuk specifikonte se cilat shkolla janë furnizuar me thëngjill dhe sasinë e furnizuar për secilën shkollë.

**Rreziku** Mungesa e dëshmime për pranimin e punëve dhe/apo furnizimeve shton rrezikun e pagesave fiktive dhe shkakton humbje të konsiderueshme financiare për komunën.

**Rekomandimi 16** Kryetari i komunës duhet të forcojë kontrollet gjatë pranimit të punëve/furnizimeve dhe të sigurojë që asnjë pagesë nuk do të bëhet pa pranimin e situacionit si dhe dokumenteve tjera mbështetëse.

### Çështja 17 - Vonesa në realizimin e projekteve - Prioritet i Mesëm

**E gjetura** Komuna me 11.02.2014 kishte paguar 129,700€ për ndërtimin e rrugës "Shpenadi - Velezhë". Kontrata për këtë projekt ishte lidhur me 19.10.2012 dhe parashihej që punët të përfundonin për 100 ditë pune. Edhe përkundër vonesës për 242 ditë pune, të tejzgatura, Komuna nuk kishte zbatuar penale ndonëse ato gjithmonë parashihen në dosje të tenderit. Kjo ka ndodhur për shkak që Komuna nuk ka arritur të vendos një menaxhim të mirëfilltë të kontratave.

**Rreziku** Mos respektimi i planit dinamik nga operatorët shkakton vonesa në realizimin e projekteve. Mos aplikimi i penaleve mund të ndikojë negativisht në përgjegjshmërinë e operatorëve ekonomik për obligimet kontraktuale ndaj komunës.

**Rekomandimi 17** Kryetari i komunës duhet të sigurojë se është bërë një analizë e shkaqeve për vonesat e gjata në përfundimin e projekteve kapitale. Kontrollet mbi menaxhimin e kontratave duhet të forcohen për të siguruar që të gjitha projektet përfundojnë brenda afateve të arsyeshme.

## 4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### Përshkrim

Shpenzimet jo përmes prokurimit kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime për të cilat nuk kërkohet prokurim. Shembuj të këtyre shpenzimeve janë komunalit, avancet për udhëtime, drekat zyrtare, shpenzimet përmes parasë së imët, etj. Janë disa aspekte të procesit të shpenzimeve jo përmes prokurimit të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive.

### Rekomandimet

---

#### Çështja 18 – Pagesa për bashkëfinancim – Prioritet i Mesëm

**E gjetura** Më datën 12.02.2014, Komuna ka transferuar në llogari të IRD-së shumën prej 10,000€ në emër të bashkëfinancimit në projektin “ Restaurimi i objekteve kulturore”. Po ashtu Komuna më datën 10.09.2014, ka transferuar shumën prej 1,000€ në llogari të IOM-it në emër të bashkëfinancimit për furnizim me pajisje për shkollën fillore “Mustafa Baku”. Këto dy projekte janë përfunduar. fillimisht, Komuna kishte bërë transferin e 11,000€ në llogaritë e dy organizatave bazuar vetëm në memorandumet për bashkë-financim.

**Rreziku** Pagesat nga Komuna tek partneri, të pa mbështetura me informata të hollësishme për bazën e shpenzimeve, mund të rezultojnë me mos përmbushjen e objektivave dhe potencialisht mund të konsiderohen pagesa të parregullta.

**Rekomandimi 18** Kryetari i Komunës duhet të rishikojë marrëveshjet e bashkë-financimit dhe analizojë mundësitë për ndalimin parapagesave. Marrëveshjet duhet të përfshijnë raportim të qartë dhe transparent për shpenzimet dhe rezultatet që formojnë një bazë për monitorim.

#### Çështja 19 – Shpenzime të larta për dreka zyrtare – Prioritet i Mesëm

**E gjetura** Edhe gjatë vitit 2014 shpenzimet për dreka zyrtare kanë qenë 111,878€, apo mesatarisht mbi 400€ për çdo ditë pune. Ne kemi testuar dy pagesa njëra në shumë prej 14,000€ dhe tjera në shumë 10,000€. Këto pagesa të bëra në vitin 2014 i takonin muajit shtator 2013. Dëshmitë për këto pagesa nuk përmbanin ndonjë agjendë të qartë të organizimit dhe personat që do të marrin pjesë.

Shpenzimet për dreka zyrtare gjatë vitit 2014 ishin më të larta se shpenzimet për subvencione për të sëmurë që nuk kanë mundësi t’i mbulojnë shpenzimet e shërimit brenda apo jashtë vendit.

**Rreziku** Shpenzimet për dreka zyrtare pa arsytim të qartë të organizimit, shton rrezikun që Komuna të paguajë për aktivitete që nuk përkojnë me objektivat e komunës dhe fondet publike të shpenzohen në mënyrë jo racionale.

**Rekomandimi 19** Kryetari i komunës duhet t'i forcojë kontrollet me rastin e shpenzimeve për dreka zyrtare. Të gjitha shpenzimet për dreka zyrtare duhet të jenë në funksion të mirëfilltë të përfaqësimit dhe shërbejnë për arritjen e objektivave të komunës. Kryetari duhet ta iniciojë hartimin e një procedure e cila përcakton limitet e lejuara dhe rregullat me rastin e shpenzimeve për dreka zyrtare.

### 4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

#### Përshkrimi

Shpenzimet për paga dhe mëditje për vitin 2014 ishin 17,766,430€ apo 99% e buxhetit për këtë kategori. Obligimet e papaguara për paga ndaj një pjese të personelit arsimor për vitin 2014 dhe tejkalimin e buxhetit për muajin janar 2015 e kemi trajtuar në kapitullin 4.2.

Pagat dhe Mëditjet paguhën përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollet që operojnë në nivel lokal nga Komuna kanë të bëjnë me: a) autorizimin e listës së pagave; b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme; dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

### 4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

#### Përshkrimi

Shpenzimet për subvencione dhe transfere për vitin 2014 ishin 521,614€ apo 97% të buxhetit. Kryesisht përfshijnë ndihma apo përkrahje për rastet sociale, organizimet kulturoro-sportive, zhvillim të bizneseve të vogla, etj.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 20 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Edhe përkundër faktit që Komuna ka një rregullore për subvencione, ajo nuk kishte arritur të vendos kontrolle efektive për menaxhimin e tyre. Si rezultat janë paraqitur dobësitë në vijim:

- Komuna kishe përkrahur në formën e subvencionit KF “Liria” në shumë 16,100€. Sipas kërkesës të bërë nga KF “Iliria”, nga 16,100€ shuma 7,000€ do të përdorej për mbulimin e pagave të mbetura nga nëntori 2013, 5,100€ si shpenzime për përgatitje në Durrës ndërsa të tjerat për ndonjë transfer. Ne kemi identifikuar që shpenzimet e bëra nga përfituesi nuk janë në pajtim me kërkesën fillestare. Me mjetet e përfituara ishin mbuluar pagat për muajin nëntor 2013 dhe janar 2014, ndërsa pjesa tjetër ishte shfrytëzuar për udhëtim në relacionin Prizren–Prishtinë;
- Komuna nga buxheti për subvencione kishte paguar operatorin “Sfinga” në shumë 7,829€ për organizimin e një manifestimi kulturor. Ndonëse ishte formuar një komision për këtë manifestim, ky i fundit nuk kishte përgatitur ndonjë raport rreth punëve dhe shërbimeve të ofruara nga OE; dhe
- Komuna kishte subvencionuar “Shoqatën e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së” me 7,000€ për rekreacion në Durrës për 38 anëtarë dhe për 4 anëtarë për trajtim në Banjën “Nëna Naile” në Kllokot. Pagesa ishte bërë pas kthimit të tyre nga bregdeti. Përfituesi nuk kishte sjellur dëshmi të mjaftueshme për arsyetimin e shpenzimeve gjatë qëndrimit në Durrës dhe Kllokot.

#### **Rreziku**

Shpenzimi i mjeteve nga subvencionet për nevoja ndryshe nga kërkesa, dhënia e mjeteve në para të gatshme si dhe shton rrezikun që paraja publike nuk është përdorur për qëllimin e caktuar dhe në përputhje me objektivat e komunës.

#### **Rekomandimi 20**

Kryetari i komunës duhet të sigurojë që rregullorja e brendshme është gjithëpërfshirëse dhe që kërkesat e saj përmbushen nga stafi i komunës përgjegjës për ndarjen e subvencioneve. Të gjitha mjetet e ndara si subvencione duhet të shpenzohen në pajtim të plotë me objektivat e komunës. Përfituesit e subvencioneve duhet të dokumentojnë me dëshmi adekuate që të gjitha fondet e përfituara janë shpenzuar në përputhje me kërkesat.

## **4.5 Pasuritë dhe detyrimet**

### **4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale**

#### **Përshkrim**

Menaxhimi i pasurive në komunën e Prizrenit është shoqëruar me dobësi të vazhdueshme.

Ne kemi identifikuar si rrezik signifikant plotësinë e pasurive të komunës. Ky rrezik ndërlidhet me saldon historike të vlerës së pasurive dhe si i tillë është trajtuar në kapitullin 2.2.

Edhe gjatë vitit 2014 Komuna ka përvetësuar pasuri të ndryshme. Pasuria nuk është reflektuar plotësisht në regjistrin kontabël.

## Rekomandimet

---

### Çështja 21 - Dobësi në menaxhimin e pasurive - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Rishikimi ynë ka identifikuar që Komuna nuk ka arritur t'i regjistrojë pasuritë e përfituara gjatë vitit 2014. Një rast i pasurisë së paregjistruar është edhe toka prej pesë ari e pranuar si donacion nga Kisha Katolike. Zyrtari i pasurisë nuk kishte bërë regjistrimet e duhura..

**Rreziku** Kontrolllet aktuale mbi pasuritë duket të jenë jo efektive. Si rezultat i kësaj, Komuna nuk ka një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e saj. Së këndejmi, nuk është e mundur të ketë edhe menaxhim të mirë dhe vendimmarrje të duhur për pasuritë në dispozicion.

**Rekomandimi 21** Kryetari i komunës duhet të sigurojë se zyrtarët e pasurisë bashkëpunojnë ngushtë me departamentet tjera për të regjistruar në mënyrë sistematike të gjitha pasuritë në pronësi të komunës, dhe se një regjistër i azhurnuar i pasurive, do të prezantohet para përpilimit të PVF për vitin 2015.

## 4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmëve

### Përshkrim

Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe organizatat i detyrohen komunës për shërbimet, punët, mallrat apo pronat që i kanë përfituar nga Komuna.

### Rekomandimet

---

### Çështja 22 - Nivel i lartë i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Shuma e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2014 arrin shifrën 14,534,000€. Zërat më të lartë që e përbëjnë këtë shumë janë:

- Tatimi në pronë 9,338,000€;
- Licenca tjera afariste 4,604,000€;
- Të arkëtueshmet nga tregjet 204,000€; dhe
- Tarifa të tjera në shumë prej 388,000€.

Borxhet e akumuluar, shuma e të cilave po rritet nga viti në vit, paraqet një nga sfidat kryesore të komunës. Kjo ka ndodhur për shkak se Komuna nuk ka arritur t'i përmbahet Rregullës Financiare për arkëtimin e të hyrave dhe të vendos mekanizma efektiv për inkasimin e tyre. Komuna ende nuk ka hartuar

një strategji mbi veprimet që duhet të ndërmerren për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme.

**Rreziku** Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme redukton aftësitë e komunës për financimin e projekteve nga të hyrat vetjake. Vonesa në hartimin e një strategjie për inkasimin e borxheve të prapambetura mund të shpie në një situatë, që në një kohë të caktuar, ato të shndërrohen në borxhe të këqija dhe të bëhen të pa mbledhshme.

**Rekomandimi 22** Kryetari i komunës duhet të krijojë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të arkëtueshmeve, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për reduktimin në nivel të pranueshëm të këtyre borxheve. Menaxhmenti duhet të inicoj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative.

### 4.5.3 Trajtimi i borxheve

#### Përshkrim

Borxhet e komunës paraqesin obligimet që Komuna kryesisht ka ndaj furnitorëve por edhe ndaj punëtorëve të vet. Edhe në komunën e Prizrenit ekziston një trend i rritjes së borxheve vit pas viti, e që reflekton një menaxhim jo të duhur të pagesave.

Edhe këtë vit Komuna ka hyrë në obligime të papaguara. Është i pakuptueshëm fakti i hyrjes në obligime përderisa shkalla e shpenzimit të buxhetit është vetëm 84% dhe ekziston përdorim i kufizuar i të hyrave vetanake.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 23 – Obligimet e papaguara - Prioritet i Lartë

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2014 ishte 2,234,878€. Këto detyrime janë bartur për pagesë në vitin 2015. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të sfidës buxhetore ngase Komuna kishte edhe detyrime kontingjente në shumë prej 3,206,000€. Sipas përvojës në të kaluarën, këto kanë gjasë reale të shndërrohen në obligime përfundimtare, duke rënduar edhe më tej situatën buxhetore të komunës.

**Rreziku** Niveli i lartë i obligimeve të papaguara dhe ngritja e obligimeve kontingjente, shton rrezikun që buxheti i komunës të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore. Një situatë e tillë mund ta shpie komunën në një gjendje të vështirë financiare që mund të ketë pasojë mosrealizimin e projekteve dhe çrregullime tjera në financimin e veprimtarive kryesore.

**Rekomandimi 23** Kryetari i komunës duhet t'i forcojë kontrollat menaxheriale duke siguruar një planifikim të hollësishëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike. Për trajtimin e borxheve të akumuluar, Kryetari duhet të paraqes një plan ku parashihen veprime konkrete për shlyerjen graduale të borxheve të komunës. Ky plan duhet të monitorohet direkt nga Kryetari i komunës.

## 4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit (KA). Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit etj.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) për vitin 2014 kishte planifikuar gjashtë auditime duke finalizuar të gjitha ato sipas planit. Fushat e mbuluara nga auditimi i brendshëm gjatë vitit 2014 ishin:

1. Raporti mbi përcjelljen e rekomandimeve të NjAB për vitin 2013;
2. Procesi i prokurimit, duke përfshirë periudhën e gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2013;
3. Menaxhimi i aktiviteteve të prokurimit për tetë muaj të vitit 2014;
4. Të hyrat vetjake për vitin 2013 dhe tremujorin e parë të vitit 2014;
5. Të hyrat nga arka kryesore për gjashtë muaj të vitit 2014, dhe
6. Të hyrat nga tatimi në pronë për 10 muaj të vitit 2014.

NjAB si rezultat i punës audituese kishte arritur të nxjerrë disa rekomandime të vlefshme për menaxhmentin. Megjithatë, menaxhmenti nuk i kishte kushtuar vëmendjen e duhur rekomandimeve të NjAB.

Me gjithë progresin e arritur nga NjAB, për shkak të fushëveprimit dhe metodologjisë së përdorur nga kjo njësi, ne nuk mund të mbështetemi në punën e NjAB-së për qasjen tonë audituese.

## Rekomandimet

---

### Çështja 24 – Auditimi i brendshëm - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Rishikimi ynë ka identifikuar që ekzistojnë disa dobësi në sistemin e auditimit të brendshëm. Këto dobësi janë paraqitur në vijim:

- Menaxhmenti nuk përgatit plane për implementimin e rekomandimeve të NjAB. Prej 32 rekomandimeve të dhëna nga raportet e NJAB, vetëm 6 prej tyre ishin adresuar; dhe
- Megjithëse ekziston Komiteti i Auditimit, ai nuk kontribuon në përmirësimin e sistemit të kontrolleve. KA cili ka mbajtur vetëm dy takime gjatë tërë vitit ku janë shqyrtuar rekomandimet e NjAB-së dhe ZAP-it. KA nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për të ndihmuar implementimin e rekomandimeve.

Këto dobësi reflektojnë një mungesë përkushtimi të menaxhmentit për njohjen e rolit të auditimit të brendshëm dhe maksimizimit të përfitimit nga sistemi.

**Rreziku** Mungesa e gatishmërisë së menaxhmentit për të pasur një KA pro-aktiv dhe për të njohur e rolit dhe rëndësinë e NjAB, mund të rezultojë me vonesa në evitimin e dobësive në kohën e duhur dhe me pasoja në mosefikasitet operacional dhe humbje financiare për komunën.

**Rekomandimi 24** Kryetari i komunës duhet të sigurojë që KA merr një rol pro-aktiv në mënyrë që të arrihet përfitimi nga aktivitetet e auditimit të brendshëm. KA do duhet që t'i rishikojë në mënyrë kritike planet dhe rezultatet e NjAB dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës.



## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht

ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

#### Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e

auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare	Kryetari duhet të identifikoj veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësoj një prezantim të drejtë dhe të saktë të pasurive në vitin 2014.		Pjesërisht	
2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF-ve të vitit 2014 të adresojë formalisht të gjitha kërkesat e pajtueshmërisë lidhur me përgatitjen e tyre, përkatësisht Rregullës Financiare 03/2013, si dhe të siguroj se ekziston linja raportuese dhe stafi menaxhues është i përgjegjshëm me rastin e raportimit të të dhënave financiare të ZKF.	Po		
2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm	Kryetari duhet të siguroj se kërkesat e raportimit të jashtëm janë përmbushur plotësisht për të arritur një raportim efektiv të Komunës, konform kornizës së raportimit të jashtëm.	Po		
3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuar - me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të monitorohet nga Kryetari në baza mujore.	Po		
4.1 Qeverisja e mirë	Kryetari i Komunës duhet të organizoj një rishikim të aspektit të raportimit nga drejtoret përkatëse për të	Po		

	përcaktuar formën e raportimit e cila mundëson menaxhmentit vendim marrjen e duhur dhe me kohë mbi mbarëvajtjen dhe monitorimin e proceseve.			
4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari i Komunës duhet të analizoj në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjen e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).		Pjesërisht	
	Kryetari duhet të siguroj se planifikimi i të hyrave bazohet në parametra real me qëllim të stimulimit të mbledhjes të sa më shumë të hyrave vetjake. Po ashtu, duhet të zbatojë një rishikim sistematik për të përcaktuar barrierat për rritjen e shkallës aktuale të inkasimit të të hyrave dhe për zvogëlimin e shkallës së borxheve historike (duke përfshirë borxhet e tatimin për biznes) si dhe të identifikojë mundësitë për përmirësim të situatës.		Pjesërisht	
4.4 Shpenzimet (prokurimet)	Kryetari i Komunës duhet të ketë parasysh rregullat financiare dhe të vendosë kontrole më të forta të departamenti i financave dhe prokurimit që të parandalohet hyrja në obligime pa fonde. Krahas sigurimit paraprak të fondeve, menaxhmenti duhet të forcoj edhe kontrollet mbi monitorimin e kontratave.			Jo
	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se Departamenti i prokurimit zbaton të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, duke u siguruar se përmes sigurimit të ekzekutimit të obligoj OE që t'i përmbahet të gjitha kushteve të kontratës. Po ashtu, duhet të siguroj se Komuna vendosë			Jo

	objektiva të qarta para se të lidhë çfarëdo marrëveshje kontraktuale me OE, dhe sigurohet se kushtet e kontratës janë të favorshme dhe arsyetojnë vlerën për parandë e shpenzuar.			
4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të shtoj kontrollet të llojet e ngjashme të shpenzimeve për të siguruar se shpenzimet janë në funksion të aktiviteteve operative të komunës, dhe si të tilla janë të bazuara dhe të arsyeshme.			Jo
4.4.3 Kompensimet ( paga dhe mëditje)	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se asnjë rekrutim i stafit nuk do të bëhet para se pagat të jenë të siguruar. Gjithashtu, rasti duhet të rishikohet dhe të gjitha pagesat ndaj stafit të bëhen sa më parë dhe praktikatat e tilla të mos përsëriten.		Pjesërisht	
	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se procesi i planifikimit të buxhetit për këta dy sektor është i ndërlidhur direkt me nevojat reale që kanë për mbulimin e pagave dhe mëditjeve, duke marrë në konsideratë përvojën e viteve paraprake.	Po		
	Kryetari i Komunës duhet të zgjidhë këtë jo konsistencë, dhe të përcaktoj nëse këto janë vetëm raste të izoluar apo një dukuri e përhapur. Varësisht nga gjendja, të forcohen edhe kontrollet për të parandaluar rastet e tilla.		Pjesërisht	
4.4.4 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se me rastin e marrjes së vendimit për subvencione të rishikohet baza ligjore. Gjithashtu ai duhet të siguroj se subvencionet, qofshin ato për furnizime me material apo transfere të mjeteve, të kërkojë nga drejtoritë përkatëse të mbajnë të gjitha informatat lidhur me përfituesit e këtyre subvencioneve dhe transfereve.		Pjesërisht	

4.5 Pasurit dhe obligimet	Kryetari duhet të siguroj se komisioni i caktuar për inventarizim të pasurisë, brenda një periudhe të caktuar kohore do të bëjë regjistrimin fizik të tyre për t'i krahasuar me gjendjen kontabël, dhe t'i sqaroj të gjitha diferencat eventuale. Gjithashtu, regjistrimi i pasurive me vlerë mbi 1,000€ duhet të jetë një proces që duhet të vazhdoj deri në regjistrimin final të të gjitha pasurive.			Jo
4.5.2 Trajtimi i të arketueshmeve	Kryetari i komunës duhet të ketë një çasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e këtij problemi, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për reduktimin në nivel të pranueshëm të këtyre borxheve. Menaxhmenti duhet të inicoj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).			Jo
4.6 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të siguroj një planifikim të hollësishëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkalar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike.	Po		
4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të adresoj rekomandimet që dalin nga auditimet e brendshme, duke alokuar përgjegjësitë të stafi përgjegjës për implementimin e rekomandimeve të dhëna. Po ashtu, duhet të siguroj se përveç gatishmërisë për adresimin e rekomandimeve, ky proces në baza të rregullta edhe të monitorohet.			Jo